



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

14 janar 2022

SCC-11-0248

Paditësja

J sh, me seli në Mitrovicë.
Përfaqësuar nga av B M, nga Gjakova.

Parashtruesi i kërkesës

S A A, Prishtinë

Kundër

E Paditur

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. “Agim Ramadani” 23, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), Kolegji i përbërë nga Sylejman Shumolli gjyqtar kryesues, Diellza Hoxha dhe Shkelzen Sylaj gjyqtarë, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur me 14 janar 2022, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Refuzohet si e pa bazuar, padia e paditëses J sh., Mitrovicë dhe Vërtetohet se Jugobanka është ndërmarrje me asete në pronësi shoqërore nën juridiksionin e AKP-së.**
- 2. Kërkesa e parashtruesit S A A, për të hyrë në procedurë refuzohet si e pabazuar.**
- 3. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 09 nëntor 2011, i autorizuari i paditëses (më tutje: paditësja) dorëzoi në Dhomën e Posaçme propozim me kërkesë për caktimin e masës së përkohshme për ndalimin e shitjes të ndërmarrjeve të reja të J, kundër Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP). Paditësja ndër të tjera pohoi se i ka plotësuar të gjitha kushtet ligjore për të u regjistruar si shoqëri aksionare dhe se Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë, me aktvendimin e vet, Fi.nr. 730/91 të datës 23 maj 1991, e ka regjistruar paditësen si Sh A, me seli në Mitrovicë. Në mbështetje të kërkesës dorëzoi: Kontratën mbi themelimin e J si SH (qershor 1995), aktvendimi i B P të J i datës 26 qershor 1995, për dhënien e pëlqimit për statusin aksionar, vendimin për ndërrimin e emrit të datës 29 qershor 1995, pëlqimin e BPJ për statusin Jugobankës si shoqëri aksionare të datës 26 qershor 1995, ekstraktin nga regjistri për regjistrimin e subjekteve ekonomike në Gjykatë, vendimin mbi ndërrimin e emrit 24 qershor 1992, kontratën për zbatimin e sanimit të

Jugobankës dd nga Tito Mitrovicë, si ish filiala kryesore e Jugobankës, dd nga Beogradi e datës 03 qershor 1991, aktvendimi i Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë Fi.nr. 730/91 i datës 23 maj 1991, aktvendimin e Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Beograd Fi. Nr. 6536/91, vendimin e Këshillit Ekzekutiv të Jugobankës, dd nga Beogradi, mbi themelimin e Bankës-filiala kryesore në Mitrovicë, me kapital prej 100 % të Jugobankës, dd nga Beogradi, aktvendimin e Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Beograd Fi. Nr. 820/90 i datës 22 janar 1990, aktvendimin e Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë i datës 17 janar 1990, vendimin mbi pushimin e punës të Bankës Themelore në Mitrovicë, i datës 11 janar 1990, vendimin mbi Regjistrin e njësisë me emrin Jugobanka nga Mitrovica Titos, vendimin mbi themelimin e Jugobankës dd Beograd-Serbi 07 dhjetor 1989 dhe aktvendimin e Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Beograd Fi.nr. 548/78.

Me 23 nëntor 2011, paditësja dorëzoi në Dhomën e Posaçme, padi kundër të paditurës AKP, me të cilën kërkoi që të vërtetohet se J sh. nuk është ndërmarrje shoqërore, por shoqëri aksionare jashtë juridiksionit të AKP, kurse e paditura AKP detyrohet të pranojë statusin aksionar të J. Paditësja pohoi se nuk ka qenë asnjëherë NSH e as nuk është transformuar asnjëherë nga NSH në Sh.A, pasi që nga themelimi është organizatë e themeluar si Shoqëri Aksionare, pasi që bankat si në të kaluarën por edhe sot organizohen me status aksionar. Më tej paditësja pohoi se nga regjistri i aksionarëve vërtetohet aksionar kryesor Jugobanka nga Beogradi me 51.25 %, pastaj Fondi për zhvillimin e Serbisë me 30.62 % dhe Beobanka nga Beogradi me 10 % të cilët bashkërisht marrin pjesë me kapital aksione rreth 91.77 %, kurse aksionarët tjerë bashkërisht 8.23 %, kështu që edhe me këtë fakt vërtetohet se paditësja nuk mund të jetë nën juridiksionin e AKP dhe se vendimet e të paditurës edhe për këto shkaqe janë të pa bazuara. Paditësja pohoi se edhe me supozim se AKP ka juridiksion ndaj Jugobankës, megjithatë nuk janë plotësuar kushtet për të shitur lokalet afariste të Jugobankës, të emërtuara si ndërmarrje të reja nga ana e AKP, pasi paraprakisht Bordi i AKP nuk e ka caktuar statusin juridik të Jugobankës edhe pse ka qenë i obliguar. Paditësja propozoi që gjykata të merr aktgjykim dhe të vërtetohet se Jugobanka Sh.A, rr. "M. Tito" nr. 46, nuk është ndërmarrje shoqërore por Shoqëri Aksionare, jashtë juridiksionit të AKP.

Po ashtu, paditësja kërkoi që e paditura të anulojë si të pabazuar vendimin e vet për shitjen-privatizimin e ndërmarrjeve të reja, respektivisht të ndërpres menjëherë të gjitha veprimet për zbatimin e tenderit AKP 53 për shitjen e Ndërmarrjeve të reja të poshtëshënuara:

- N e R J Ndërtesa Kryesore e Administratës Mitrovicë Sh.P.K
- N e R J Zyra në Mitrovicë Sh.P.K.
- N e R J Zyra 1 në Prishtinë Sh.P.K.
- N e R J Zyra 2 në Prishtinë Sh.P.K.
- N e R J Zyra në Viti Sh.P.K.
- N e R J Zyra në Pejë Sh.P.K.
- N e R J Zyra në Istog Sh.P.K.
- N e R J Zyra në Gjakovë Sh.P.K.
- N e R J Zyra në Skenderaj Sh.P.K.
- N e R J Zyra në Dragash Sh.P.K.
- N e R J Zyra në Rahovec Sh.P.K.
- N e R J Zyra në Klinë Sh.P.K.
- N e R J Zyra në Zveçan Sh.P.K.

- N e R J Zyra në Zubin Potok Sh.P.K.

Me 29 nëntor 2011, e paditura AKP parashtroi përgjigje në kërkesën për masë të përkohshme, në të cilën pohoi se i kundërshton të gjitha pretendimet e paditëses të paraqitura në kërkesën për nxjerrjen e masës së përkohshme, duke i konsideruar si të pa bazuara në ligj. E paditura pohoi se Jugobanka si organizatë e pavarur financiare, është themeluar sipas Ligjit mbi kushtet dhe sistemin bankar financiar të vitit 1977 (Gaz. Zyr. E RSFJ 77/2), bazuar në nenin 49 të këtij Ligji, bankat si institucione financiare, kanë mundur të organizoheshin si banka themelore, interne dhe të bashkuara ndërsa Jugobanka si organizatë themelore financiare, është organizuar si bankë themelore. Po ashtu e paditura pohoi se Jugobanka është themeluar në vitin 1977, nga 112 subjekte që afaronin me kapital shoqëror në bazë të Marrëveshjes Vetëqeverisëse të vitit 1977. Më tej e paditura pohoi se transformimi është bërë në mënyrë të dhunshme dhe nën masat e dhunshme, vendimi për transformim ishte nxjerrë në rrethana diskriminuese dhe se kundërshtohet legjitimiteti dhe vlefshmëria e tij nga personat që në atë kohë ishin anëtarë të strukturave udhëheqëse të kësaj banke. Në mbështetje të përgjigjes ka dorëzuar dokumentet në kopje si: marrëveshjen për themelimin e Jugobankës të vitit 1977, statutin e Jugobankës të vitit 1977, aktvendimin Fi-49/78 të datës 15 shkurt 1978 dhe evidencën e njëjësive punuese, aktvendimin e Gjykatës Ekonomike në Prishtinë Fi-2/89 të datës 17 janar 1990, aktvendimin për regjistrim në Gjykatën Ekonomike në Prishtinë nr. 730/91 të datës 23 maj 1991, vendimin e Kuvendit të themeluesve nr. 76 i datës 11 janar 1990, vendimin e Kuvendit të Republikës së Serbisë të datës 07 gusht 1990, SDR i NSH Jugobanka me seli në Mitrovicë i datës 10 gusht 2011 dhe fletën poseduese nr. 3365 e lëshuar me datë 26 prill 2004 si pronë shoqërore.

Me 18 maj 2012, paditësja parashtroi propozim të ri për caktimin e masës së përkohshme të ndalimit të shitjes, me të cilën AKP i ndalohet të shesë përmes tenderit publik AKP 55 të datës 30 maj 2012 ndërmarrjet e reja dhe këtë: ndërmarrjen e re Jugobanka zyra në Prizren, ndërmarrjen e re Jugobanka zyra në Klinë dhe ndërmarrja e re Jugobanka ndërtesa kryesore Administrative në Mitrovicë. Paditësja ndër të tjera pohoi se konsideron se vendimi i AKP për shitjen e Ndërmarrjeve të reja të lartpërmendura është i pa bazuar dhe i kundërligjshëm pasi që paditësja nuk mund të jetë nën juridiksionin e AKP, e as të shitet nga AKP. Në mbështetje të kërkesës ka bashkangjitur kopjen e dokumenteve të cilat ishin dorëzuar në gjykatë kur ishte dorëzuar kërkesa e parë për caktimin e masës së përkohshme e sigurisë me 09 nëntor 2011.

Me 15 qershor 2012, e paditura parashtroi përgjigje në kërkesën për caktimin e masës së përkohshme, në të cilën pohoi se i kundërshton të gjitha pretendimet e paditëses të paraqitura në kërkesë, duke i konsideruar si të pa bazuara në ligj. E paditura pohoi se paditësja kërkesën për masë të përkohshme e ka mbështetur në fakte dhe dëshmi të supozuara. Paditësja nuk ka ofruar asnjë fakt për një të drejtë legale e cila ka ekzistuar pasi që juridikisht kjo ndërmarrje është e organizuar si NSH dhe administrohet nga Agjencia. Po ashtu e paditura pohoi se e njofton trupin gjykoës se objekti i kërkesës për masë të përkohshme të parashtruar nga paditësi është kauzalisht i lidhur me lëndën C-I-12-0039. Si paditës në atë rast është Salal Ahmetgjekaj kundër Agjencisë e me të cilën kërkonte masën e përkohshme, lidhur me objektin e saj në Prizren. Në atë rast (C-I-12-0039) gjykata ka konstatuar se kërkesës për masë të përkohshme i mungojnë dëshmitë dhe argumentet ashtu siç kërkohet me nenin 55 të Shtojcës së Ligjit për Dhomën e Posaçme nr. 04/L-033, një konstatim i tillë Dhoma e Posaçme e ka shprehur me aktvendimin e saj për refuzimin e kërkesës për masë të përkohshme.

Me 24 janar 2013, Dhoma e Posaçme me aktvendimin e saj SCC-11-0248, e ka refuzuar propozimin për caktimin e masës së sigurisë. Kolegji i Apelit me aktvendimin AC-I-13-0021, të datës 27 mars 2014, ankesën e paditësit e ka hedhur poshtë si të papranueshme.

Me 06 mars 2014, e paditura parashtroi mbrojtje në padi, në të cilën propozoi që kërkesëpadia e paditëses të refuzohet si e pa bazuar në ligj. E paditura pohoi se janë të pa bazuara deklaratimet e paditëses se kemi të bëjmë me shoqëri aksionare dhe nuk kemi të bëjmë me pronë shoqërore, nga se SDR i aprovuar nga AKP, vërtetohet fakti se kemi të bëjmë me organizatë bankare me asete në pronësi shoqërore dhe nuk kemi të bëjmë me shoqëri aksionare sepse gjendja juridike para datës 22 mars 1989 vërteton faktin se kemi të bëjmë me kapital në pronësi shoqërore. Po ashtu e paditura pohoi se është i pa argumentuar dhe i pa bazuar qëndrimi i palës kundërshtare se kjo ndërmarrje nuk është shoqërore, një qëndrim të tillë AKP e ka shprehur në të gjitha çështjet gjyqësore dhe e ka argumentuar ligjërisht. Më tej e paditura pohoi se me vendimin e protokolluar nr. 76 të datës 11 janar 1990, të i ashtuquajturit Kuvendi i Bankës Themelore J në Mitrovicë me 21 shtator 1989, në mënyrë të kundërligjshme ndërpret punën e Bankës Th- J në Mitrovicë dhe me fillim të vitit 1990, fillon punën si filjala kryesore J Sh. Beograd. Sipas të paditurës vendimi për transformim ishte nxjerrë në rrethana diskriminuese dhe kundërshtohet legjitimiteti dhe vlefshmëria e tij nga personat që në atë kohë ishin anëtarë të strukturave udhëheqëse të kësaj banke.

Me 04 qershor 2014, paditësja parashtroi përgjigje në mbrojtjen e të paditurës, në të pohoi se mbrojtja e të paditurës është e pa bazuar. Paditësja pohoi se SDR i përpiluar nga një komision i të paditurës, i zgjedhur nga Bordi i Drejtorëve të AKP, të cilin e paditura e përmend si provë për të arsyetuar mbrojtjen e vet, paraqet një akt të njëanshëm të palës së paditur, i cili nuk duhet të prodhojë efekt juridik. Për faktin se vendimi i gjykatës kompetente me të cilin paditësja është regjistruar si SHA mund të anulohet dhe të ndryshohet vetëm me ndonjë aktgjykim të plotfuqishëm të gjykatës kompetente. Po ashtu paditësja pohoi se aktvendimi i Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë Fi 54/78 të datës 13 janar 1978 me ndryshimet dhe plotësimet e datës 23 maj 1991 (Fin r. 730/91) me të cilin vërtetohet se paditësi është regjistruar si SHA, paraqet një aktvendim të formës së prerë dhe ekzekutiv, i cili prodhon efekt juridik, pasi që gjer më tani askush nuk ka iniciuar ndonjë procedurë gjyqësore për anulimin e tij, duke përfshirë këtu edhe të paditurën.

Me 20 shkurt 2017, e paditura parashtroi kundërpërgjigje, në të cilën pohoi se mbetet në tërësi pranë deklaratimeve dhe kundërshtimeve të parashtruara në Dhomën e Posaçme. E paditura pohoi se paditësja në përgjigjen e saj nuk ka paraqitur ndonjë provë, dëshmi apo fakt të ri për të cilin AKP më përgjigjen e parashtruar nga paditësja do të mund të deklarohet dhe paraqes argumentet e saja, andaj kërkon nga gjykata që ta refuzojë padinë e paditëses si të pa bazuar në ligj.

Me 21 gusht 2017, përfaqësuesi i palës S (A) A, me parashtrësë kërkoi që të hyjë në procesin kontestimor në cilësinë e ndërhyrësit në anën e paditëses. Parashtruesi pohoi se është paditës në rastin gjyqësor C-I-12-0040 kundër AKP si e paditur dhe se ka interes juridik për të mbështetur paditësen konkretisht J Sh. me seli në Mitrovicë, me të cilin bashkohet në gjykim në rastin gjyqësor SCC-11-0248. Parashtruesi pretendon se është pronar i patundshmërisë,

ngastrës kadastrale nr. P-71813068-02127-4, në sipërfaqe prej 129 m² si dhe të ndërtesës me etazhitet P+1 të ndërtuar në këtë ngastër kadastrale me etazhitet P+1 në sipërfaqe prej 258 m², e cila patundshmëri gjendet në Prizren në rrugën “R A” në bazë të kontratës mbi shitblerjen e patundshmërisë nr. 468 të datës 20 prill 2010, të cilën parashtruesi e ka lidhur me pronarin J SH, me seli në Mitrovicë. Parashtruesi propozoi që të miratohet si e bazuar deklarata e tij për hyrje në procesin kontestimor në rastin SCC-11-0248 në cilësinë e ndërhyrësit në anën e paditësit J SH, me seli në Mitrovicë.

Me 23 gusht 2017, Dhoma e Posaçme mbajti seancë dëgjimore.

Me 13 shtator 2021, Dhoma e Posaçme, në këtë çështje ka caktuar dhe mbajtur seancë dëgjimore.

Përfaqësuesi i paditëses si në seancë dëgjimore ashtu edhe në fjalën e tij përfundimtare (të dorëzuar me shkrim), ndër të tjera ka deklaruar se, paditësja nuk mund të jetë nën juridiksionin e AKP-së, e as të administrohet, e as të shitet nga e paditura, pasi sipas dispozitave të nenit 392 të Ligjit mbi ndërmarrjet të ish Jugosllavisë ndërmarrje shoqërore është ajo ndërmarrje, e cila në tërësi punon me mjete shoqërore. Kështu që bazuar në faktin se Jugobanka sh.a Mitrovicë, nuk ka punuar e as nuk punon me kapital shoqëror, por punon me kapital aksionar të theksuar në Kontratën mbi Th e J, në statut dhe në aktvendimin e Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, me çka vërtetohet fakti se paditësja është shoqëri aksionare, e jo NSH. Po ashtu paditësja ka deklaruar se i ka plotësuar të gjitha kushtet ligjore për tu regjistruar si shoqëri aksionare, kështu që për këtë arsye Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë me aktvendimin e vet Fi. nr. 730/91 të datës 23 maj 1991 e ka regjistruar si Shoqëri Aksionare, me seli në Mitrovicë. Fakti se paditësja e ka statusin e SHA është vërtetuar edhe me aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në Prizren PKR.nr. 415/13 të datës 01 nëntor 2017. Dispozitat e ligjit për themelimin e të paditurës, i japin të drejtë të paditurës të administrojë vetëm ndërmarrjet shoqërore në territorin e Kosovës, por jo edhe ndërmarrjet shoqërore të shteteve tjera, në këtë rast Serbisë, bazuar në faktin se pronar-aksionar janë Jugobanka me seli në Beograd me 51.25 %, pastaj fondi për zhvillimin e Serbisë me 30 % dhe aksionarët tjerë bashkërisht 8.23 %. Po ashtu paditësja ka pohuar se me leximin e pasqyrës tabelare të datës 13 shtator 2021, vërtetohet se paditësja nga shuma e përgjithshme prej 296,259,955.00 € të kursimeve të vjetra devizore, me gjendje të datës 30 shtator 2010 në emër të kthimit të kursimeve të vjetra devizore ka paguar shumën e përgjithshme prej 194,025,241.00 €, kurse për disa raste të moskthimit respektivisht mos pagesës të kursimeve të vjetra devizore, vërtetohet se në kuadër të shumës së mbetur të pakthyer të kursimeve të vjetra devizore përfshihen palët e përmendura në këtë pasqyrë tabelore (I, A, etj). Paditësja propozoi që të aprovohet si e bazuar dhe të vërtetohet se J është Sh A, si dhe të anulohen të gjitha vendimet dhe kontratat të lidhura me palët e treta për shitjen dhe privatizimin e aseteve të paditëses.

Përfaqësuesi i palës së paditur në seancën dëgjimore dhe në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim, ndër të tjera ka deklaruar se nga SDR i aprovuar nga AKP vërtetohet fakti se kemi të bëjmë me organizatë bankare me asete në pronësi shoqërore dhe se Jugobanka ishte entitet juridik i krijuar në bazë të nenit 119, të Ligjit mbi bazat e sistemit kreditor dhe bankar (Gazeta Zyrtare RSFJ nr. 2/77) dhe nenit 55 të Marrëveshjes Vetëqeverisëse mbi bashkimin në Bankën Themelore Jugobankën Mitrovicë dhe të nenit 1 të Statutit të Bankës themelore Jugobanka në

Mitrovicë. Në rastin në fjalë Jugobanka është e regjistruar si “B Th” në Gjykatën Ekonomike në Prishtinë (Fi. 49/78) ku edhe si e tillë ka funksionuar deri në vitin 1990 (Fi. 2/89), në bazë të Ligjit mbi kreditë dhe sistemet bankare të zbatueshëm në atë kohë, është përcaktuar si një organizatë e pavarur financiare. Po ashtu e paditura ka pohuar se thujse të gjithë themeluesit anëtarë të bankës ishin organizata bazë dhe organizata të tjera të punës së bashkuar, të cilët edhe kanë menaxhuar me Jugobankën e që ekskluzivisht asetet e tyre përbënin kapital shoqëror të Jugobankës. Më tej e paditura pohoi se transformimi i Jugobankës nga NSH në SH ishte i kundërligjshëm dhe fiktiv, si dhe ky transformim ishte bërë me aplikimin e masave të dhunshme. E paditura propozoi që padia të refuzohet si e pa bazuar.

Për detaje të tjera referimi mund të bëhet në dosjen e lëndës.

Arsyetimi ligjor:

Kërkesëpadia e paditëses “Jugobanka” është e pa bazuar.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se *pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësit apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese)*, ndërsa pika 3 parasheh se, *pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.*

Sipas nenit 5.1 të Ligjit të Agjencisë, AKP ka kompetenca ekskluzive që të administroj:

- i) Ndërmarrjet në pronësi shoqërore pavarësisht nëse i janë nënshtruar transformimit apo jo;*
- ii) Të gjitha asetet që ndodhen në territorin e Kosovës, pavarësisht a janë të organizuara si subjekte apo jo të cilat kanë qenë në pronësi shoqërore më ose pas muajit mars të vitit 1989, dhe*
- iii) Të gjitha aksionet në korporata dhe korporata vartëse të themeluara sipas këtij ligji dhe të gjitha interesat në pronësi shtetërore në një ndërmarrje apo subjekt tjetër juridik pavarësisht nëse ajo ndërmarrje apo subjekt i është nënshtruar transformimit.*

Neni 1 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24, 12 dhjetor 1999, për ligjin në fuqi në Kosovë, pika 1, 1.1 përcakton:

(a) Rregulloret e shpallura nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm dhe instrumentet ndihmëse të nxjerra në përputhje me to dhe

(b) Legjislacionin në fuqi në Kosovë më 22 mars 1989.

Në rast konfliktesh do të mbizotërojnë rregulloret dhe instrumentet ndihmëse të nxjerra në përputhje me to.

1.2. Në qoftë se një gjykatë e juridiksionit kompetent, një organ ose një person që duhet të zbatojë një dispozitë të legjislacionit, konstaton se një çështje ose një situatë nuk mund të mbulohet nga legjislacioni i përcaktuar në paragrafin 1.1 të kësaj rregulloreje, por mbulohet

nga një ligj tjetër në fuqi në Kosovë pas 22 marsit 1989, i cili nuk është diskriminues dhe është në përputhje me nenin 1.3 të kësaj rregulloreje, atëherë gjykata, organi ose personi, si përjashtim, e zbaton atë ligj.

1.3. Gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, të gjithë personat me detyra publike ose që mbajnë pozita publike duhet të respektojnë standardet e njohura ndërkombëtare të të drejtave të njeriut siç pasqyrohen veçanërisht në:

- (a) Deklaratën universale të të drejtave të njeriut të 10 dhjetorit 1948;
- (b) Konventën Evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut të 4 nëntorit 1950 dhe Protokollet e saj;
- (c) Marrëveshjen ndërkombëtare për të drejtat qytetare dhe politike të 16 dhjetorit 1966 dhe protokollet e saj;
- (d) Marrëveshjen ndërkombëtare për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore të 16 dhjetorit 1966;
- (e) Konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racial të 21 dhjetorit 1965;
- (f) Konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër grave të 17 dhjetorit 1965;
- (g) Konventën kundër torturës dhe keqtrajtimit çnjerëzor dhe poshtëruës apo degradues ose ndëshkues të 17 dhjetorit 1984;
- (h) Konventën ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve të 20 dhjetorit 1989.

Marrëveshja Vetëqeverisëse mbi Bashkimin në Bankën Themelore Jugobanka në Mitrovicë e vitit 1977, përkatësisht neni 1 i kësaj marrëveshje, si akt që është themeluar ky etnitet juridik ka paraparë:

Përmes firmosjes së kësaj marrëveshjeje, Zyra Qendrore e Mitrovicës së Kosovës,, krijon bankën themelore të Mitrovicës së Kosovës. Të drejtat, obligimet dhe përgjegjësit e Jugobankës,- Mitrovica e Kosovës, tek personat e tretë dhe operativët e ZQ Mitrovica e Kosovës, marrin përsipër bankën Jugobanka (në tekstin në vijim: Banka), më datën e firmosjes në regjistrat gjyqësor.

Neni 1 i Statutit të Bankës Themelore Jugobanka në Mitrovicë i vitit 1977 parasheh:

Banka themelore Jugobanka e Mitrovicës (në tekstin në vijim: Banka), është organizatë financiare vetë menaxhuese, në të cilën bashkimi i mjeteve dhe punëve, si dhe firmosja e marrëveshjes së vetë menaxhimit në bashkimin në Bankë Themelore të Jugobankës Mitrovicë, kanë krijuar organizatat themelore si dhe të tjerat të punëve të përbashkëta, bashkësi vetë qeverisëse të interesit, banka interne dhe persona tjerë juridiko- social, për realizimin e interesave të përbashkëta si dhe në sigurimin e fondeve monetare për arritjen e zgjerimit dhe avancimit të aktiviteteve të tyre si dhe për realizimin e interesave tjera të përbashkëta, gjithashtu për realizimin e veprimtarive të kreditorëve financiar, si dhe punëve të tjera bankare.

Në këtë mënyrë gjykata konstaton se në këtë çështje, kontestuese në mes të palëve është statusi i Ndërmarrjes “Jugobanka”, përkatësisht fakti se a është Ndërmarrje Shoqërore me kapital shoqëror, apo është Shoqëri Aksionare. Sipas paditëses, e njëjta është themeluar si shoqëri aksionare dhe se nuk ka qenë asnjëherë NSH, e as nuk është transformuar asnjëherë nga NSH në Sh.A. AKP nuk ka juridiksion për të administruar ndërmarrjet të cilat janë në pronësi të një shteti tjetër. Ndërsa sipas të paditurës ndërmarrja “Jugobanka” ka statusin e Ndërmarrjes Shoqërore me kapital shoqëror dhe se transformimi i bërë nuk mund të konsiderohet valid, për arsytet e cekura më lartë. Nga SDR i aprovuar nga AKP, vërtetohet fakti se kemi të bëjmë me

organizatë bankare me asete në pronësi shoqërore dhe nuk kemi të bëjmë me shoqëri aksionare sepse gjendja juridike para datës 22 mars 1989 vërteton faktin se kemi të bëjmë me kapital në pronësi shoqërore.

Gjykata vlerëson se gjendja juridike e Jugobankës, para datës 22 mars 1989 vërteton faktin se kemi të bëjmë me organizatë bankare me asete në pronësi shoqërore dhe se nuk kemi të bëjmë me shoqëri aksionare, andaj kjo ndërmarrje bie nën juridiksionin e AKP, sipas nenit 5 të Ligjit për AKP. Jugobanka ishte themeluar si entitet juridik në vitin 1977, duke u bazuar në Ligjin mbi bazat e sistemit kreditor dhe bankar dhe në Marrëveshjen Vetëqeverisëse mbi bashkimin në Bankën Themelore Mitrovicë, si dhe në Statutin e Bankës Themelore Jugobanka në Mitrovicë. Jugobanka ishte e regjistruar si “B Th” në Gjykatën Ekonomike në Prishtinë sipas aktvendimit për regjistrimin në regjistrin e gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë Fi. 49/78 të datës 15 shkurt 1978 dhe kështu kishte funksionuar deri në vitin 1990. Si pasojë e transformimit, me aktvendimin Fi-2/89 të Gjykatës Ekonomike në Prishtinë është fshirë nga regjistri i gjykatës dhe më pastaj është regjistruar si subjekt i ri me aktvendimin Fi-730/91 të datës 23 maj 1991 dhe me këtë veprim edhe de juro është regjistruar si subjekt me kapital aksionar.

Gjykata vërteton faktin se Jugobanka ishte themeluar në vitin 1977, nga 112 subjekte që afaronin me kapital shoqëror në bazë të Marrëveshjes Vetëqeverisëse të vitit 1977, dhe se në Kuvendin e themeluesve, është nxjerrë Statuti i bankës si akt themelor për përcaktimin e kushteve dhe kriterëve të bazuar në Ligjin për themelimin e bankës. J si organizatë financiare është themeluar sipas Ligjit mbi kushtet dhe sistemin bankar financiar të viti 1977 (G. Z. e ish RSFJ 77/2), përkatësisht në nenin 49 të këtij ligji, si bankë themelore. Themelues të bankës ishin organizatat e punës së bashkuar, bashkësitë vetëqeverisëse të interesit, bankat interne dhe personat tjerë juridik shoqëror, duke i bashkuar mjetet e punës dhe kapitalin.

Nga Marrëveshja Vetëqeverisëse mbi Bashkimin në Bankën Themelore Jugobanka në Mitrovicë vërtetohet fakti se shumica e themeluesve të bankës ishin organizata bazë dhe organizata të punës së bashkuar, të cilat edhe kanë menaxhuar me J dhe se asetet e tyre përbënin kapital shoqëror, andaj edhe konsiderohet se institucioni financiar i formuar ishte me kapital shoqëror. Agjencia Kosovare e Privatizimit, bazuar në mandatin e saj ligjor, sipas SDR të datës 10 gusht 2011 të NSH Jugobanka me seli në Mitrovicë, ka konstatuar se pas analizimit të statutit të kësaj NSH, historikun e saj dhe ndryshimin e kapitalit, mënyrën e organizimit, të qeverisjes së këtij entiteti, kemi të bëjmë me një subjekt juridik i cili është qeverisur mbi bazë të kapitalit me pronësi shoqërore.

Gjykata vlerëson se si çështje me rëndësi në zgjidhjen e këtij kontesti është fakti i transformimit të Jugobankës që ishte bërë në vitet e 90-ta. Transformimi i ndërmarrjes, ka ndodhur në vitin 1990 dhe në bazë të ligjit mbi AKP-në dhe rregulloreve pararendëse të UNMIK-ut, një transformim i tillë mund të pranohet vetëm nëse është bërë në mënyrë ligjore dhe në mënyrë jo diskriminuese. Gjykata duke marrë në shqyrtim argumentimin e dy çështjeve kryesore në këtë rast, si ligjshmërinë e transformimit dhe jo diskriminimin gjatë procesit të transformimit të statusit të kësaj ndërmarrje, vie në përfundim se një transformim i tillë nuk është bërë duke i respektuar dispozitat ligjore dhe kështu një transformim i tillë, as atëherë por as tani, nuk mund të prodhojë efekte juridike.

Në rastin konkret gjykata vlerëson se miratimi i vendimit për transformimin ishte bërë nga Organet e përkohshme të vendosura në të gjitha NSH që ishin subjekte që e kishin themeluar Jugobankën në vitin 1977 dhe nën ekzistimin e këtyre rrethanave përfaqësuesit e këtyre subjekteve, të vendosur pas instalimit të masave të dhunshme kishin dhënë pëlqimin për ndërrimin e statutit të subjektit bankar dhe për themelimin e një banke të re me kapital aksionar. Statuti Themeltar i vitit 1977 dhe i tërë dokumentacioni i subjektit Jugobanka, paraqesin bazën ligjore për të konkluduar se ky subjekt është në pronësi shoqërore dhe bie nën administrimin e AKP-së.

Gjykata vlerëson se të gjitha transformimet e bëra, veçanërisht pas datës 22 mars 1989 janë të pabazuara në ligjet pozitive dhe në kundërshtim me rendin juridik, kushtetues, pasi që në atë kohë vetëm se ishin të instaluarat masat e dhunshme në institucionet publike dhe ndërmarrjet shoqërore në Kosovë. Procedurat e ndërmarra për transformimin e subjektit në fjalë nga Ndërmarrja Shoqërore në Shoqëri Aksionare janë zhvilluar pas abrogimit të autonomisë së ish KSAK-së dhe gjatë instalimit të ligjeve diskriminuese nga Republika e Serbisë. Në kohën kur pretendohet se është ndërruar statusi i ndërmarrjes, përkatësisht në vitin 1990, në institucionet dhe ndërmarrjet shoqërore kanë qenë të instaluarat masat e dhunshme dhe shumicës së punëtorëve shqiptarë iu është ndërprerë marrëdhënia e punës në mënyrë të dhunshme dhe kundër vullnetit të tyre. Andaj në atë kohë, nuk ka mundur të jetë një transferim ligjor i ndërmarrjes dhe jo diskriminues, përderisa punëtorët shqiptarë nuk kanë marrë pjesë në transformim dhe nuk është respektuar vullneti i tyre.

Sipas rregullave të përgjithshme për barrën e të provuarit, pala duhet të dëshmojë faktet me të cilat e mbështet padinë e saj, (neni 35.2.4 dhe 42.3 i Ligjit për Dhomën e Posaçme, neni 7 i LPK-së). Në bazë të këtyre rregullave paditësi do të duhej të dëshmonte faktin se vendimet transformuese nuk janë nxjerrë në rrethana diskriminuese dhe kështu për të vërtetuar legjitimitetin dhe vlefshmërinë e këtyre veprimeve nën rrethanat që kanë ekzistuar në atë kohë.

Pretendimi i paditëses se nuk ka qenë asnjëherë NSH, e as nuk është transformuar asnjëherë nga NSH në SHA, për gjykatën është i pa bazuar. Siç është arsyetuar më lart Jugobanka ishte themeluar kryesisht nga subjekte juridike të cilat kishin kapital shoqëror. Kësisoj edhe subjekti i ri që kishin krijuar edhe pse ishte emërtuar si SHA, ishte me kapital shoqëror. Veprimet e transformimit ishin ndërmarrë gjatë kohës kur ishin instaluar masat e dhunshme në shumicën e institucioneve dhe ndërmarrjeve shoqërore. Nga kjo lë të kuptohet se para transformimit Jugobanka asetet nuk i kishte në pronësi aksionare, por ishin të organizuar në një formë tjetër, përkatësisht kapitali ishte de facto dhe de juro në pronësi shoqërore.

Pretendimi tjetër i paditëses se e ka statusin e shoqërisë aksionare është vërtetuar edhe me aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në Prizren Pkr.nr. 415/13 të datës 01 nëntor 2017, është i pabazuar. Gjykata gjen se sipas aktgjykimit Pkr.nr. 415/13 të datës 01 nëntor 2017 ishin liruar nga aktakuza D K dhe E I të cilët ishin akuzuar se njëri në cilësi të drejtorit të Jugobankës kishte nënshkruar kontratën për shitjen e një lokali aset i Jugobankës me një palë të tretë, kurse tjetri në cilësi të personit zyrtar e kishte vërtetuar këtë kontratë. Në atë procedurë është vendosur në lidhje me përgjegjësinë penale të të lartcekurve për një aset në pronësi të Jugobankës. Si përfundim janë liruar nga përgjegjësia penale ndër të tjera edhe për faktin se shkresa informuese e datës 05 janar 2010 (me të cilën është informuar gjykata komunale në

Gjilan se aseti për të cilin është lidhur kontrata është nën administrimin e AKP), i është dorëzuar referentit civil, e jo zyrës së pranimit ashtu siç duhej. Në këtë rast lirimi i të akuzuarve nga akuza, nuk e orienton zgjidhjen e kësaj çështje në drejtim të aprovimit të kërkesëpadisë së paditëses, aq më pak kur lirimi i tyre është bërë ndër të tjera me arsyetimin se shkresa informuese nuk ishte dorëzuar në adresën e caktuar. Mbështetja e kërkesëpadisë nga ana e paditëses në atë vendim gjykate është tek një paragraf i cili në mënyrë përgjithësuese i referohet organizmit të bankave. Është krejtësisht e pa vend që paditësja të mbështes kërkesëpadinë e saj në një rast penal, me pohimin se gjykata e ka konfirmuar se paditësja nuk është NSH por SHA. Nëse gjykata ka konstatuar një fakt të tillë siç pretendon paditësja, tanimë cila është arsye që kërkohet nga Dhoma e Posaçme që të vërtetohet statusi ligjor i ndërmarrjes dhe cila është arsyeja e qëndrimit të paditëses pranë kësaj padie. Thënë shkurt ky pretendim nuk meriton arsyetim të mëtejshëm.

Konstatimi i Gjykatës Themelore në Prizren se “sipas ligjit mbi bazat e sistemit kreditor dhe bankat (Gazeta Zyrtare e RSFJ) numër 2/77 banka themelore është organizatë vetëqeverisëse financiare e jo ndërmarrje shoqërore” dhe se “sipas Ligjit për Bankat, Institucionet Financiare dhe institucionet financiare jo bankare, Ligji numër 04-L-093, banka është shoqëri aksionare e angazhuar në veprimtari bankare dhe se nga kjo rrjedh se bankat nuk e kanë statusin e ndërmarrjes shoqërore dhe nuk mund të jenë nën administrimin e AKP ashtu siç pretendon akuza”, nuk është i drejtë. Me këtë konstatim nuk pajtohet dhe nuk është e lidhur kjo gjykatë, për faktin se nuk ka qenë dhe nuk është nën juridiksionin e gjykatave tjera në procedurë civile e aq më pak në një rast penal, për të caktuar statusin juridik të një ndërmarrje që është nën menaxhimin e AKP. Juridiksion ekskluziv për vërtetimin e statusit ligjor në këtë kontest specifik ka vetëm Dhoma e Posaçme.

Paditësja pretendon se ajo ka përmbushur një pjesë të detyrimeve ndaj deponuesve të mjeteve devizore dhe se ky fakt dëshmon se me të vërtetë Jugobanka ka qenë dhe është shoqëri aksionare. Gjykata këtë pretendim e gjen si të pa bazuar për faktin se në këtë procedurë nuk është objekt shqyrtimi dhe nuk mund të vërtetohet çështja e kursimeve të qytetarëve të deponuara tek Jugobanka dhe kthimi i një pjese të depozitave tek të njëjtit. Më tej, gjykata vlerëson se edhe nëse paditësja ka kthyer ndonjë shumë të depozitave, duhet të merret parasysh fakti se që nga ndërrimi i statusit të Jugobankës pas vitit 1990, paditësja ka marrë nën administrim ndërmarrjen. Kësisoj ka disponuar me kapitalin e Jugobankës, përfshirë edhe depozitat që kanë depozituar qytetarët para ndërrimit të statusit por edhe pas ndërrimit të tij. Andaj edhe është detyrim për ti kthyer të njëjtat. Kjo çështje mbetet e hapur dhe nuk e përjashton obligimin e bankës për t'i kthyer depozitat që i kishte nën administrim. Për më tepër çështja e depozitave të qytetarëve mund të vlerësohet në ndonjë procedurë tjetër, varësisht nga kërkesat e palëve që mund të kenë interes juridik për një çështje të tillë.

Në bazë të Nenit 76.3, të Ligjit për Dhomën e Posaçme lidhur me Nenin 271 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, Gjykata konstaton se kërkesa e ndërhyrësit për të hyr në këtë proces kontestimor në anën e paditësit është e pabazuar. Në këtë çështje objekt kontesti është vetëm statusi ligjor i ndërmarrjes Jugobanka. Parashtruesi ka iniciuar një procedurë tjetër (C-I-12-0039) në lidhje me pretendimet e tij rreth blerjes së ngastrës kadastrale nr. P-71813068-02127-4 në sipërfaqe prej 129 m² dhe objektit që gjendet në të, në sipërfaqe prej 258 m². Gjykata vlerëson se parashtruesi mund të ketë interes ligjor në zgjidhjen e këtij rasti mirëpo kërkesa e

tij për të hyr në këtë proces kontestimor në anën e paditësit nuk i ndihmon apo kontribuon paditësit pasi që natyra e këtij kontesti është tipike ligjore. Parashtruesi vetëm synon të fitoj të drejtën e pronësisë mbi pronën në fjalë në bazë të një kontrate të shitblerjes të lidhur në vitin 2010, përderisa objekt shqyrtimi siç është arsyetuar në këtë rast është vlerësimi i një transformimi të bërë gjatë viteve të 90-ta.

Gjykata konsideron se ka vlerësuar të gjitha pretendimet relevante të palëve në lidhje me objektin e kontestit. Nuk ka pretendime të tjera të cilat mund të ndikojnë për të vendosur ndryshe në këtë çështje.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenin 54.1 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Taksat gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta. Paditësja i ka paguar taksat gjyqësore për padinë dhe kërkesat për masë të sigurisë.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Sylejman Shumolli, Gjyqtar kryesues

Diellza Hoxha, Gjyqtare

Shkelzen Sylaj, Gjyqtar